



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Prishtinë, më 11/07/2018

Ref. Nr. 6-2801

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 5 paragrafi 4, nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, dhe nenit 16 paragrafi 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, (Gazeta Zyrtare nr. 14/9 shtator 2011), nenin 17 paragrafet 5 dhe 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. (22.03.2011), Udhëzimit administrativ për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të situara jashtë Republikës së Kosovës (nr.16/2016), dhe kërkesës nr.6/4-2801 të datës 04/06/2018 së znj. Liridona Buqa, Këshilli Shtetëror për Njohje, nxjerr:

VENDIM

1. Znj. Liridona Buqa i njihet grada "Profesor i Diplomuar i gjuhës dhe Letërsisë Angleze", studime katër vjeçare, 240 ECTS e fituar në "Universiteti i Tetovës", Maqedoni.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga ju, Këshilli Shtetëror për Njohje vendosi që të njihet grada e fituar në "Universiteti i Tetovës" në Maqedoni, ashtu si është e precizuar në dokumentin e lëshuar nga ky institucion "Profesor i Diplomuar i gjuhës dhe Letërsisë Angleze". Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga kandidatja dhe nga informacionet e marra nga institucionet përkatëse nga vendi ku janë kryer studimet, Këshilli Shtetëror për Njohje vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Këshilla Juridike: Pala e pa kënaqur me vendimin ka të drejtë të parashtojë kërkesë për rishqyrtim të vendimit, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

Vendimi i dërgohet:

1. Palës;
2. Komisionit;
3. Qendrës NARIC;
4. Arkivit në MASHT.



Kumtije Gajica

Kryeshtetëse e Këshillit Shtetëror për Njohje